



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.85

24 korrik

2012

P Ë R M B A J T J A

Vendim i KM
nr. 403, datë 20.6.2012

Për miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Drogës,
2012-2016.....

Faqe

4299

VENDIM
Nr. 403, datë 20.6.2012

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE KUNDËR DROGËS, 2012-2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Drogës, 2012-2016, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojnë planin e veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare kundër Drogës, 2012 - 2016.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj strategjie.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRATEGJIA KOMBËTARE KUNDËR DROGËS
2012-2016

1. PARATHËNIE

Abuzimi me drogat është një fenomen global. Asnjë vend nuk është i imunizuar nga problemet që shoqërojnë prodhimin, trafikimin dhe përdorimin e paligjshëm të drogave, por ata mund të mësojnë nga njëri-tjetri, duke studiuar e zbatuar praktikatat më të mira në përballimin e këtij fenomeni.

Shteti shqiptar e njeh dhe e pranon natyrën serioze të problemit, si në nivelin kombëtar ashtu dhe në atë ndërkombëtar, si dhe pranon faktin se në luftën kundër drogave mund të jemi të suksesshëm vetëm nëse koordinojmë përpjekjet tona, ato të qeverisë, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Lufta kundër drogës mbetet një nga prioritetet kryesore të shtetit shqiptar, sepse përbën një rrezikshmëri të lartë për qytetarët tanë dhe për impaktin potencial në procesin integruar të Shqipërisë në BE.

Besojmë se përpjekjet tona do të kontribuojnë për të vënë nën kontroll efektet e drogës ndaj komunitetit dhe se vendi ynë do të luajë një rol të rëndësishëm në përpjekjet ndërkombëtare për të luftuar drogat.

2. ANALIZA E SITUATËS

2.1 Problemet lidhur me prodhimin, trafikimin dhe shpërndarjen e drogave (oferta)

Gjatë periudhës 2004-2010, Shqipëria zbatoi një Strategji Kombëtare Antidrogë. Pas vlerësimit të kryer mbi shkallën e zbatimit të kësaj strategjie për sa i përket uljes së ofertës, u arrit në përfundimin se në përgjithësi Shqipëria ka pasur sukses në zbatimin e programit të saj për reduktimin e prodhimit e trafikimit të drogave, për garantimin e një kontrolli efektiv dhe sigurimin e territorit të saj. Forcimi i veprimit të ligjit dhe i bashkëpunimit kombëtar e ndërkombëtar ka



ndihmuar në sigurimin më të mirë të kufijve tanë dhe reduktimin e të gjitha llojeve të trafikimit. Është shënuar një përmirësim i konsiderueshëm në sigurimin e vijës bregdetare, transportit ajror, si dhe të kufirit në përgjithësi. Është përmirësuar edhe profesionalizmi i Policisë së Shtetit. Janë marrë masa për modernizimin e pajisjeve dhe shtimin e trajnimeve.

Përgjatë viteve të fundit disa prej organizatave më të mëdha kriminale janë eliminuar dhe një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të tyre kanë dalë para drejtësisë. Mundësia që grupet kriminale të trafikimit të drogës të operojnë lirshëm në territorin shqiptar është reduktuar ndjeshëm.

Kanabisi është e vetmja bimë narkotike që kultivohet në Shqipëri. Gjatë periudhës 1993-2000 kultivimi i kanabis ishte shtrirë pothuaj në gjithë territorin e vendit. Me masat energjike të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, duke kombinuar me sukses veprimtarinë parandaluese me masat shtrënguese, është arritur minimizimi i fenomenit vetëm në disa zona të kufizuara. (Shih statistikat, aneksi nr. 1.)

Në lidhje me trafikun e marijuanës (produkt i kanabisit) me origjinë nga Shqipëria, destinacioni kryesor i trafikimit është Greqia dhe Italia. Trafikimi i marijuanës bëhet kryesisht nëpërmjet kalimit të paligjshëm të “kufirit të gjelbër”, si dhe në sasi më të kufizuara nëpërmjet pikave të kalimit të kufirit, nëpërmjet porteve me tragete apo nëpërmjet detit me mjete të shpejta lundruese. Marijuana është droga që konsumohet më shumë në vendin tonë. Çmimet në nivel rruge janë ngritur dhe më 2010-ën çmimi për 5 g marijuanë varionte nga 500 deri në 1000 lekë. Përqindja e THC-së në nivel rruge është rreth 4 %. (Shih statistikat, aneksi nr. 1.)

Lufta kundër trafikimit të heroinës mbetet një nga prioritetet kryesore të agjencive të zbatimit të ligjit në përgjithësi dhe të Policisë së Shtetit në veçanti.

Shqipëria, si vend tranzit, preket nga këto linja të trafikimit të heroinës: Turqi-Bullgari-Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë-Shqipëri ose Turqi-Bullgari-Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë-Kosovë-Shqipëri. Në raste shumë të rralla, janë konstatuar hyrje të sasive të heroinës nga Greqia. Për trafikun e heroinës kryesisht përdoren mjetet e transportit tokësor, si: kamionë, autobusë, autovetura etj. Greqia dhe Italia janë destinacionet kryesore për heroinën që tranzitohet përmes Shqipërisë dhe sasi shumë të kufizuara dërgohen në vende të tjera europiane. Një pjesë e heroinës qëndron në Shqipëri për konsumatorët vendas. Pas marijuanës, heroina është droga e dytë që konsumohet më shumë në vendin tonë, por më e rrezikshme për sa i përket jetës dhe shëndetit të përdoruesve. Viti 2007 shënoi një rritje të lehtë të çmimit të heroinës në nivel rruge (3000 lekë për 1 gram), por gjatë viteve 2008-2010, çmimi nuk u rrit më tej. Pastërtia tipike e heroinës në nivel rruge është 1 %. (Shih statistikat, aneksi nr. 1.)

Nga rastet e evidentuara deri tani, rezulton se kokaina vjen në Shqipëri në sasi shumë të kufizuara, kryesisht nga korrierët ose dërgesat me postë nga SHBA-ja ose nga vendet e Amerikës së Jugut, tradicionalisht të njohura për prodhimin e saj. Gjatë vitit 2010, u konstatuan rastet e para të trafikimit të kokainës nëpërmjet kontejnerëve nga vendet e Amerikës së Jugut, duke kaluar më parë tranzit në shtete të ndryshme europiane. Sasi relativisht të vogla kokaine dërgohen më tej në Greqi dhe Itali. Gjithashtu, është vënë re një rritje nga viti në vit i numrit të rasteve të kapjes së kokainës dhe numrit të autorëve të implikuar në këto raste. Pas marijuanës dhe heroinës, kokaina është droga e tretë që konsumohet më shumë në vendin tonë. Çmimi për 1 g kokainë varion nga 7000 deri në 10000 lekë. (Shih statistikat, aneksi nr. 1.)

Për sa u përket drogave sintetike, nuk ka tregues apo të dhëna që të vërtetojnë ekzistencën e trafikut të këtyre drogave tranzit apo me destinacion vendin tonë, përveç ndonjë rasti sporadik. Gjithashtu, konsumi i këtyre lëndëve ende nuk përbën problem për vendin tonë.

Është e rëndësishme të përmendet fakti se rritja e efikasitetit të agjencive të angazhuara në luftën kundër drogave ka çuar në rritjen progresive të numrit të rasteve dhe të autorëve të arrestuar, si dhe rritjen në përgjithësi të sasive të drogave të sekuestruara. Për rrjedhojë, grupet kriminale po kërkojnë metoda dhe rrugë të reja të trafikimit. (Shih statistikat, aneksi nr. 1.)

Gjatë viteve të fundit është shënuar një rënie e ndjeshme për sa i përket trafikimit të drogave me origjinë apo të tranzituara nëpërmjet Shqipërisë për në drejtim të Greqisë dhe të Italisë. Kjo konfirmohet edhe nga statistikat e dërguara zyrtarisht nga pala italiane. (Shih statistikat, aneksi nr. 2.)

Me gjithë përpjekjet e suksesshme dhe rezultatet e mira të arritura deri tani, trafikimi i drogave mbetet një nga aktivitetet e paligjshme më fitimprurëse të krimit të organizuar së bashku me trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandën, krimin ekonomik dhe pastrimin e parave.

2.2 Problemet me shëndetin dhe trajtimi (kërkesa)

Numri i përgjithshëm i të rriturve (15-64 vjeç) në Shqipëri, të cilët kanë provuar lloje të drogave të paligjshme (eksperimentues), është vlerësuar të jetë aktualisht ndërmjet 40000 dhe 60000. Ky vlerësim bazohet në rezultatet e disa studimeve mbi sjelljet me risk të rinjtë e shkollave të mesme dhe disa studime tëurvejancës biologjike dhe të sjelljes në grupe me risk të moshave të ndryshme në popullatë.

Lidhur me prevalencën e përdorimit të paktën një herë gjatë gjithë jetës, të drogave të paligjshme, këto studime tregojnë se 5-7 % e personave të moshës 15-18 vjeç kanë eksperimentuar me kanabisin, rreth 4 % me ekstazi, mbi 1 % me heroinë dhe 2-3 % me kokainë. Prevalenca është më e lartë në kryeqytet, krahasuar me pjesën tjetër të vendit; ndërkohë që vërehet një përhapje disa herë më e lartë e përdorimit të meshkujt krahasuar me femrat.

Numri i përdoruesve problematikë të drogës (persona që abuzojnë me drogat dhe kanë probleme serioze nga përdorimi i tyre) në vend, luhet në vlerësime të ndryshme nga 4800 në 8600 individë.

Prej më se 15 vitesh, në Shqipëri, shërbimet e specializuara lidhur me abuzimin me drogat ofrohen vetëm nga shërbimi i toksikologjisë klinike pranë Qendrës Spitalore Universitare, ndërkohë që nuk ka ende struktura publike ambulatorie, shërbime ditore dhe shërbime komunitare me shtretër për problemet me drogën. Ekzistojnë edhe dy qendra të tjera trajtimi, të cilat janë private dhe jofitimprurëse, “Qendra Emanuel”, që ofron trajtim rezidencial, dhe “Aksion Plus”, e cila ofron trajtim zëvendësues me metadon.

Të dhënat e ofruara nga Shërbimi i Toksikologjisë Klinike në QSUT, që nga viti 1995 e në vazhdim, tregojnë prirjet në ecurinë e kohës. Numri total i vizitave në këtë klinikë është rritur në mënyrë të ndjeshme, deri në vitin 2002, duke qëndruar pothuajse konstant në vitet në vazhdim me rreth 800-900 pacientë në vit (2003-2010). Këtyre shifrave u shtohen edhe mbi 200 pacientë në vit në mjekim mbajtës me metadon nga rrjeti i qendrave të “Aksion Plus” dhe rreth 80 pacientë të trajtuar nga qendra rezidenciale Emanuel. Përdoruesit e shërbimeve për drogën janë në shumicën dërrmuese meshkuj nga qyteti.

Personeli i specializuar që punon në këtë fushë është shumë i pakët dhe sistemi i kualifikimit të tyre është ende i parregulluar si duhet.

Mungojnë barnat bazë për trajtimin e problemeve të abuzimit me substancat në shërbimet shëndetësore, por aksesit për to në tregun e lirë farmaceutik është relativisht i lehtë.

Në fushën e edukimit dhe ndërgjegjësimit të publikut vërehet një rritje e volumit të aktiviteteve, por ende ato nuk janë të koordinuara si duhet, jo sistematike dhe varësia nga donatorët i bën të paqëndrueshme.

Gjithashtu, volumi i aktiviteteve të monitorimit dhe të kërkimit mbi abuzimin me substancat narkotike apo psikotrope, ka ardhur duke u rritur dhe forcuar gjatë dekadës së fundit, ndërkohë që ngelet më shumë për të bërë lidhur me publikimet shkencore dhe dokumentimin sistematik.

Në përfundim, mund të thuhet se në Shqipëri shërbimet e trajtimit për problemet e drogës dhe alkoolit janë ende në një fazë fillestare të zhvillimit të tyre, por ekzistojnë mundësi të shumta jo vetëm për rritjen dhe përsosjen e këtyre shërbimeve, por sidomos për ndërtimin e tyre në mënyrë të përshtatshme bazuar në nevojat reale të vendit. (Për më shumë detaje shih raportin kombëtar mbi hartëzimin e shërbimeve, si dhe raportin kombëtar mbi drogat.)



Në vendin tonë ekzistojnë ligje që synojnë të kontrollojnë çështje të lidhura me prodhimin, trafikimin dhe aksesin e qytetarëve ndaj drogave, si dhe ndaj alkoolit, por mungon një kuadër ligjor specifik që të rregullojë çështjet e lidhura me abuzimin me substancat, i tillë që të garantojë organizimin e sistemit të trajtimit, personelin dhe trajnimin e tij, si dhe strukturën dhe standardet e shërbimeve.

Gjithashtu, konstatohet se komponenti i uljes së kërkesës për drogë ka mbetur i fragmentuar dhe me financim të pamjaftueshëm, ndërkohë që reduktimi i ofertës dhe çështjet e zbatimit të ligjit përbëjnë një pjesë integrale të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe janë pjesë e përpalesive të qeverisë shqiptare. Për këtë arsye, është e domosdoshme të sigurohet, që në të ardhmen, edhe reduktimi i kërkesës për drogë të fitojë të njëjtën rëndësi si një politikë prioritare, po aq sa reduktimi i ofertës.

3. METODOLOGJIA DHE STRUKTURA

Strategjia Kombëtare Kundër Drogës 2012-2016 është hartuar nga një grup pune i ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 125, datë 9.6.2010 me pjesëmarrjen e ekspertëve nga të gjitha institucionet e përfshira në parandalimin dhe luftën ndaj këtij fenomeni, dhe me kontributin e mbështetjen e çmuar të organizatave jo qeveritare dhe ekspertëve të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri.

Strategjia Kombëtare Kundër Drogës 2012-2016, mbështetet në përvojën, arritjet pozitive dhe në praktikat më të mira të përfuara gjatë zbatimit të Strategjisë Kombëtare Antidrogë 2004-2010, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Kjo strategji është një manifestim i angazhimit të shtetit shqiptar për të arritur standardet ndërkombëtare në luftën ndaj këtij fenomeni, si dhe për të ardhur në ndihmë të individëve apo grupe individësh të prekur nga konsumi i drogave.

Përpara hartimit të kësaj strategjie, grupi i punës ka bërë një vlerësim të shkallës së zbatimit të objektivave dhe masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare Antidrogë 2004-2010, ku kanë dalë në pah arritjet pozitive, por edhe të metat e vëna re gjatë kësaj periudhe.

Gjatë procesit të hartimit të kësaj strategjie, sidomos në procesin e analizës së situatës dhe identifikimit të prioritetëve kanë ndihmuar mjaft edhe aktivitetet e kryera në funksion të përgatitjes së disa dokumenteve mbi drogat në Shqipëri sipas instrumenteve të propozuara prej Qendrës Europiane të Monitorimit të Drogave dhe Varësisë nga Drogat (European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction) dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH).

Vlen gjithashtu të përmendet, se po gjatë këtij procesi, është miratuar nga Këshilli i Ministrave vendimi nr. 299, datë 14.4.2011 “Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e Komitetit Kombëtar të Bashkërendimit të Luftës kundër Drogës, Sekretarisë së këtij Komiteti dhe Zyrës së Sistemit Kombëtar të të Dhënave për Drogën””. Këto struktura do të shërbejnë si një bazë e mirë për zbatimin e objektivave të kësaj strategjie.

Strategjia është strukturuar në mënyrë të tillë që të identifikojë qartë qëllimet dhe objektivat.

Katër janë shtyllat kryesore mbi të cilat është mbështetur kjo strategji:

1. Koordinimi strategjik;
2. Ulja e ofertës dhe e aksesit ndaj drogave;
3. Ulja e kërkesës;
4. Reduktimi i dëmit.

Për të lehtësuar zbatimin praktik të Strategjisë, do të hartohen, miratohen e zbatohen njëri pas tjetrit, dy plane veprimi për periudhat 2012-2014 dhe 2014-2016, ku do të përshkruhen masat dhe aktivitetet specifike për të arritur objektivat e kësaj Strategjie të shoqëruara me kostot dhe mbështetjen financiare.

Planet e veprimit do të mundësojnë lidhjen e kësaj Strategjie me reforma dhe strategji të tjera të rëndësishme kombëtare, si: reformën shëndetësore, reformën legislative e gjyqësore,

Strategjinë Kombëtare kundër Krimin të Organizuar dhe Terrorizmit, Strategjinë Kombëtare të Luftës kundër AIDS, Strategjinë kundër Pastrimit të Parave etj.

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare 2012-2016 dhe planeve të veprimit do të financohen nga Buxheti i Shtetit dhe donatorë të tjerë.

4. MISIONI

Strategjia ka për mision mbrojtjen e sigurisë publike, jetës dhe shëndetit të individëve e komuniteteve nëpërmjet minimizimit të rrezikut dhe të dëmeve që vijnë nga droga përmes një veprimi të koordinuar kombëtar.

5. PARIMET KRYESORE TË STRATEGJISË

Parimet kryesore të Strategjisë Kombëtare kundër Drogës rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventat e Kombeve të Bashkuara dhe marrëveshjet ndërkombëtare, legjislacioni kombëtar në këtë fushë, si dhe në objektivat që shoqëria jonë ka përpaparë në procesin për anëtarësim në Bashkimin Europian.

Këto parime kryesore janë:

- Parimi i ligshmërisë;
- Parimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- Parimi i mbrojtjes së jetës, sigurisë dhe shëndetit të individëve dhe komuniteteve;
- Parimi i zbatimit të një përqasjeje të integruar e të balancuar, bazuar mbi marrjen e përgjegjësisë dhe partneritetin.

6. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM TË STRATEGJISË

1. Krijimi i një mjedisi të sigurt për shoqërinë përmes uljes së ofertës dhe aksesit ndaj drogave për përdorim të paligjshëm;

2. Parandalimi i abuzimit me drogat përmes rritjes së ndërgjegjësimit të publikut për rreziqet dhe pasojat negative të përdorimit të drogës;

3. Minimizimi i problemit të përdorimit të drogave në gjithë shoqërinë, duke siguruar në kohën e duhur trajtimin e përshtatshëm, shërbimet rehabilituese përkatëse dhe të reduktojë dëmin që vjen nga konsumi i paligjshëm i drogave.

4. Ofrimi i një politike koordinuese dhe menaxhuese në luftën kundër drogave, si dhe krijimi i një sistemi efikas të mbledhjes dhe analizimit të informacionit.

7. ULJA E OFERTËS PËR DROGË DHE AKSESIT NDAJ DROGËS (objektivi 1)

Trafikimi i lëndëve narkotike vazhdon të mbetet një nga format më fitimprurëse të krimin të organizuar jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon e më gjerë. Organizatat dhe grupet kriminale përveç ndarjes së brendshme të detyrave, karakterizohen nga një përshtatshmëri ekstreme me kushtet e reja, duke bashkëpunuar ngushtë me grupet kriminale të rajonit dhe më gjerë.

Lufta kundër këtyre grupeve dhe organizatave kriminale vazhdon të mbetet në qendër të vëmendjes së strukturave ligjzbatuese në vendin tonë. Rritja e efikasitetit në këtë veprimtari, kërkon ngritjen në nivel më të lartë të bashkëpunimit mes institucioneve dhe agjencive të zbatimit të ligjit brenda vendit, si: Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financës, Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Punëve të Jashtme, por edhe Policia e Shtetit, doganat, Prokuroria dhe Shërbimi Informativ Shtetëror. Në këtë drejtim është e nevojshme të vazhdojë me intensitet puna për arritjen e rezultateve të qëndrueshme të drejtuara nga hetimet proaktive.

Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar është një kusht tjetër i domosdoshëm për efikasitet në goditjen e rrjeteve kriminale të trafikimit ndërkombëtar të narkotikëve. Shqipëria po luan një rol të rëndësishëm në përpjekjet ndërkombëtare kundër drogës, kontribut i njohur edhe nga partnerët dhe organizmat ndërkombëtarë. Qëllimi ynë është që ta çojmë në nivele më të larta këtë bashkëpunim.

Një drejtim tjetër i rëndësishëm është ulja e mëtejshme e prodhimit të kanabisit.

7.1 Objektivat specifikë në uljen e ofertës për drogë janë:

1. Parandalimi dhe ulja në mënyrë të ndjeshme e prodhimit të drogës në Shqipëri;



2. Vështirësimi i aksesit ndaj drogave për përdorim të paligjshëm nëpërmjet goditjes me intensitet të lartë të individëve, grupeve apo organizatave kriminale, që ushtrojnë veprimtari kriminale në formën e shitjes, shpërndarjes, trafikut të brendshëm dhe atij ndërkombëtar të drogave;

3. Dobësimi i financave të rrjeteve kriminale të përfshira në aktivitetet kriminale në fushën e drogës, si dhe i strukturave që i mbështesin duke shënjestruar, sekuestruar e konfiskuar pasuritë dhe asetet e fituara në mënyrë të paligjshme;

4. Parandalimi dhe goditja e përdorimit të paligjshëm dhe trafikut të prekursorëve nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit efikas.

7.2 Treguesit kryesorë të performancës

- Rritja deri më 2016-ën me 30 % të numrit të kapjeve për rastet e shitjes e trafikimit të drogave, duke u nisur nga të dhënat e vitit 2010;

- Ulja deri më 2016-ën me 50 % të numrit të kapjeve dhe bimëve të asgjësuar për rastet e kultivimit të bimëve narkotike, duke u nisur nga të dhënat e vitit 2010;

- Mbajtja në nivele të ulëta të treguesve për sasi të drogave të sekuestruara nga vendet fqinje me origjinë apo të tranzituara nga Shqipëria, duke u nisur nga të dhënat e vitit 2010;

- Kryerja çdo vit e jo më pak se 50 operacioneve, ku janë përdorur teknikat speciale hetimore;

- Kryerja çdo vit e jo më pak se 30 operacioneve ku janë përdorur forma të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar;

- Rritja deri më 2016-ën me 40 % të numrit të referimeve dhe procedimeve për hetimin e aseteve kriminale të individëve, grupeve e organizatave kriminale, duke u nisur nga të dhënat e vitit 2011.

7.3. Prioritetet

Për arritjen e objektivave në uljen e ofertës për drogë, puna do të përqendrohet në prioritetet e mëposhtme:

7.3.1 Legjislacioni dhe forcimi i institucioneve

Shqipëria ka bërë përparime të dukshme në hartimin e legjislacionit vendas në fushën e luftës kundër drogave, si dhe ka aderuar në të tria Konventat e Kombeve të Bashkuara në fushën e drogës.

Megjithatë, duke parë perspektivën e integritit të vendit tonë në familjen europiane, ka ardhur koha për një rishikim të aspekteve të ndryshme të legjislacionit kombëtar me synim përmirësimin e mëtejshëm të tij në përputhje me Konventat Ndërkombëtare dhe legjislacionin e BE-së në këtë fushë.

Gjatë zbatimit të kësaj Strategjie, pas studimit të problematikave dhe marrjes së mendimit nga institucionet përkatëse, si dhe në përputhje me rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë që mund të ndihmojnë në këtë proces, do të përgatiten dhe propozohen ndryshime në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale, por edhe në ligje të tjera e akte nënligjore nëse do të jetë e nevojshme. Disa mendime që janë shfaqur qoftë edhe nëpërmjet iniciativave të ndryshme ligjore në Kuvendin e Shqipërisë për ndryshimet që kërkohen, kanë të bëjnë me rishikimin e politikave të dënimit, përfshirë konsumin e lëndëve narkotike, trafikimin e brendshëm të drogave etj. Në Kodin e Procedurës Penale do të synohet të përfshihen teknikat speciale hetimore, si “dorëzimi i kontrolluar”, por edhe teknika të tjera, që kanë dalë bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare etj.

Institucionet e përfshira në uljen e ofertës duhet të parashikojnë konsolidimin e mëtejshëm të strukturave të tyre, duke vënë në dispozicion burimet e nevojshme njerëzore dhe trajnimin e vazhdueshëm të tyre, si dhe modernizimin e mëtejshëm të pajisjeve e mjeteve teknike. Vëmendje të veçantë duhet t’u kushtohet trajnimeve të përbashkëta mes institucioneve.

7.3.2 Ulja e mëtejshme e prodhimit të lëndëve narkotike

Ky prioritet do të zhvillohet në dy drejtime: atë të uljes së mëtejshme të kultivimit të bimëve narkotike, si dhe në drejtim të kontrollit e parandalimit të trafikimit të prekursorëve, që shërbejnë për prodhimin e lëndëve narkotike.

Në drejtimin e parë kërkohet një përfshirje e gjerë e institucioneve dhe aktorëve të tjerë, kryesisht për parandalimin e fenomenit, por edhe në mbështetjen e agjencive ligjzbatuese për goditjen e elementëve kriminalë të përfshirë në këtë aktivitet të paligjshëm. Kërkohet që institucionet përkatëse, të hartojnë dhe zbatojnë kryesisht politika dhe projekte zhvillimi në zonat problematike. Pushteti vendor, drejtoritë pyjore, Policia e Shtetit dhe SHISH, të bashkëpunojnë më mirë për të siguruar një monitorim efikas të territorit, si dhe për goditjen e individëve apo grupeve që merren me kultivimin e paligjshëm të bimëve narkotike, si dhe për zbulimin e rasteve të kultivimit.

Në drejtimin e dytë kërkohet një bashkëpunim më i mirë mes Ministrisë së Shëndetësisë, doganave dhe Policisë së Shtetit për evidentimin e kontrollin e subjekteve të licencuara për prodhimin, importimin, eksportimin, shitjen e barnave narkotike apo psikotrope, si dhe të prekursorëve. Ministria e Shëndetësisë duhet të krijojë bazën e të dhënave për të gjitha licencat e lëshuara, ku të sigurohet akses edhe për doganat dhe Policinë e Shtetit. Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet regjistrimit në sistemin “PEN ON LINE” të INCB-së për kontrollin e prekursorëve duhet të koordinojë aktivitetet për parandalimin e shmangies nga destinacioni të këtyre substancave, duke bashkëpunuar ngushtë me doganat dhe Policinë e Shtetit. Kjo e fundit, në bashkëpunim me Prokurorinë duhet të hetojë rastet e dyshuara në bazë të raportimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe doganave ose mbi të dhënat e siguruar në rrugë të tjera.

Është e domosdoshme për arritjen e standardeve ndërkombëtare edhe ngritja në vend e sistemit të paralajmërimit të hershëm për drogat e reja që shfaqen në treg, si dhe rifresikimi i listës së lëndëve narkotike apo psikotrope nën kontroll në shkallë vendi.

7.3.3 Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional për goditjen e trafikut e shpërndarjes së lëndëve narkotike, si dhe për sekuestrimin e aseteve kriminale

Vëmendje e veçantë do t’u kushtohet sistemeve të grumbullimit e menaxhimit të informacioneve dhe shfrytëzimit me efikasitet të tyre. Policia e Shtetit, Shërbimi Informativ i Shtetit, doganat dhe shërbimet e tjera informative duhet të shkëmbejnë informacionet mes tyre, si dhe të realizojnë operacione e aktivitete të përbashkëta në luftën kundër drogës në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë. Ngritja e njësisë të përbashkëta në luftën kundër aspekteve të veçanta të luftës kundër drogës, si p.sh., lufta kundër trafikimit të drogave nëpërmjet kontejnerëve etj., do të inkurajohet gjatë zbatimit të kësaj Strategjie.

Progres i dukshëm duhet të arrihet në planifikimin e zhvillimin e hetimeve proaktive kundër grupeve dhe organizatave kriminale të trafikut e shpërndarjes së drogave nga Policia e Shtetit. Vlerësimet strategjike dhe ato të kërcënimit për krimin e organizuar duhet të orientojnë dhe drejtojnë njësitë e zbatimit të ligjit në aktivitetet e tyre antidrogë.

Policia Kufitare do të konsolidojë rezultatet pozitive të arritura deri tani mbi bazën e analizës së riskut dhe do të synojë të përmirësojë më tej kontrollin kufitar. Analiza e riskut duhet të perfeksionohet e zhvillohet më tej edhe nga doganat, të cilat duhet të arrijnë rezultatet e tyre të pavarura në luftën kundër drogës.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet të sigurojë një sistem efikas kontrolli për të parandaluar futjen e lëndëve narkotike në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Prokuroria, Policia e Shtetit, Ministria e Financave duhet të rrisin bashkëpunimin për zbulimin dhe sekuestrimin e pasurive dhe aseteve kriminale të individëve, grupeve apo strukturave kriminale të përfshira në prodhimin, shitjen e trafikimin e lëndëve narkotike.

7.3.4 Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar

Së pari, do të konsolidohet dhe çohet më tej bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me organizatat dhe organizmat ndërkombëtarë, si: UNODC (Zyra e Kombeve të Bashkuara për



Drogën dhe Krimin), INCB (Bordi Ndërkombëtar i Kontrollit të Narkotikëve), EMCDDA (Qendra Europiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësisë nga Drogat), duke shkëmbyer informacione dhe duke plotësuar në kohë pyetësorët, formularët dhe detyrime të tjera që rrjedhin në zbatim të konventave ndërkombëtare.

Së dyti, do të rritet më tej bashkëpunimi nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, por edhe kryerjes së operacioneve të përbashkëta me policitë e vendeve të rajonit dhe më gjerë, si dhe me organizma të tjerë ndërkombëtarë të krijuar në bazë të marrëveshjeve e protokolleve ku vendi ynë ka aderuar, si: INTERPOL, EUROPOL, SELEC etj. Kërkohej arritja e rezultateve të qëndrueshme në operacionet e përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë.

Gjatë zbatimit të kësaj Strategjie do të synohet arritja e nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi operacional me EUROPOL-in, si dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me vendet e rajonit për aspekte të ndryshme në zbatim të Konventës së Bashkëpunimit Policor në Europën Juglindore (Konventa e Vjenës).

Shqipëria do të marrë pjesë aktivisht në të gjitha iniciativat aktuale dhe ato që mund të krijohen në të ardhmen me qëllim intensifikimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e drogës. Do të intensifikohet më tej shkëmbimi i informacioneve me oficerët e kontaktit të vendeve të huaja në Shqipëri, me zyrën e DEA-s në Romë, si dhe i oficerëve të vendit tonë në vendet e tjera.

8. ULJA E KËRKESËS PËR DROGË

8.1 Parandalimi i abuzimit me drogat përmes rritjes së rolit të shkollës dhe ndërgjegjësimit të popullatës (objektivi 2)

Programet e parandalimit mbulojnë një gamë të gjerë aktiviteteve, që zakonisht përfshijnë programe bazuar në shkollë, fushata të medias dhe programe bazuar në komunitet.

Eksperiencia ka treguar se individët që hyjnë në rrjedhat e përdorimit të drogës, kanë një probabilitet të madh të vazhdojnë këtë rrugë, dhe kërkohen përpjekje tepër të mëdha për mosvazhdimësi. Kjo lidhet me adiksionin si një faktor tepër të fortë, faktorë të tjerë që janë shkak për fillimin e përdorimit të drogave, plus edhe faktorë të tjerë të shtuar.

Përpjekjet e investuara në mbrojtjen e të rinjve, për një nivel të shëndetshëm në mjediset e tyre kryesore, sidomos shkollat, besohet se kanë qenë më efektive dhe produktive krahasuar me përpjekjet për të “rikuperuar” ata që tashmë e kanë filluar.

Të dhënat dhe eksperiencia nga kontingjentet që kanë rënë pre e drogave, dëshmojnë se fillimet zakonisht janë në moshë të re dhe kryesisht në ambiente apo në kontekste/mikrokomunitete shkollore. Në ndryshim nga prindërit, shkolla zotëron kapacitete, mjete, strategji, mjedise dhe faktorë të tjerë, të cilat mund të vihen përballë adiksionit dhe faktorëve të tjerë negativë. Institucioni shkollor mund të angazhojë kapacitete shumë më tepër se deri tani, dhe në mënyrë të veçantë mund të kapërcejë përtej propagandës së përgjithshme në një plan konkret e veprues. Përdorimi i drogës dhe institucioni shkollor janë të lidhur shumë ngushtë në përpjesëtim të zhdrejtë, domethënë niveli i lartë i përdorimit të drogës sjell ulje të parametrave dhe përkeqësim të aspekteve arsimore dhe nga ana tjetër, një mjedis i shëndetshëm shkollor është parakushti më i mirë kundër përhapjes së drogës ndër të rinjtë.

Besohet se kostot për përpjekjet e parandalimit parësor, nëse janë efektive, janë shumë herë më pak se dëmet që mund të ishin shkaktuar ose që do t'i kushtonin shoqërisë për të rikuperuar apo për t'u mbrojtur nga pasojat që lidhen me përdorimin e drogave.

8.2 Parandalimi bazuar në mjediset shkollore

8.2.1 Qëllimet dhe drejtimet kryesore

1. Të krijohet një mjedis i shëndetshëm, që të garantojë në mënyrë të natyrshme një mbrojtje, imunitet, prezencë permanente të pjesës antidrogë, që të përfshijë njohuri e dije bashkëkohore, shprehje, aftësi dhe aplikim të dijeve, aspekte ekstrakurrikulare në funksion të këtij qëllimi, prezencën e aktorëve të duhur, monitorim, perceptim dhe evidentim të organizuar etj.

